



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Vendimit të Kuvendit të Komunes për formimin e Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunes së Lipjanit 15Nr.013-17190 i datës 02.05.2014, Vendimit për organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave të lokalitetit 15Nr.013-23130 të datës 06.05.2015, Vendimit të Kuvendit të Komunes për miratimin e raportit të punës të Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunes së Lipjanit 15Nr-205-53130 i datës 28.10.2015 si dhe nenit 20 par. 1 të Statutit të Komunes së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunes në mbledhjen e mbajtur me 18. 12. 2015, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunes, miratoi këtë :

VENDIM

PËR PAGESËN E MEDITJEVE TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE TË FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

OBLIGOHET, Drejtorati për Buxhet dhe Financa të bëjë ekzekutimin e pagesës së meditjeve për kompenzimin e punës së anëtarëve të Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunes së Lipjanit.

Neni 2

Pagesa për një meditje (për një ditë pune) do të jetë në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro)

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunes dhe Drejtorati për Administratë – Sektori për punë të Kuvendit dhe të Komiteteve.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunes .

15Nr. 400 - 61561
Lipjan, më 21. 12. 2015

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

